



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

VENDIM

NR. 59, DATË 05.08.2020

MBI

**NDRYSHIMIN E TË DHËNAVE TË PARAQITURA NË KËRKESËN PËR
MARRJEN E LICENCËS NGA SHOQËRIA "ORA" SH.A., PËR NDRYSHIMIN E
EMRIT TË SUBJEKTIT AUDIOVIZIV NGA "TV ORA NEWS" NË "TV ORA"**

Autoriteti i Mediave Audiovizive, i përbërë nga:

Gentian	Sala	Kryetar
Sami	Nezaj	Zëvendëskryetar
Agron	Gjekmarkaj	Anëtar
Gledis	Gjipali	Anëtar
Suela	Musta	Anëtar

mori në shqyrtim çështjen që i përket palëve:

Kërkues: Shoqëria "Ora" sh.a.

Objekt: Mbi shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë "Ora" sh.a., për ndryshimin e emrit të subjektit audioviziv nga "Tv Ora News" në "Tv Ora".

Baza Ligjore: Neni 19, pika 16 i ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar,

VËREN SE:

Këshilli Kombëtar i Radio dhe Televizionit (KKRT sot Autoriteti i Mediave Audiovizive), me vendimin nr. 550, datë 28.12.2006 ka licencuar shoqërinë "Ora" sh.a., për subjektin audioviziv privat vendor "Tv Ora News", ndërsa me vendimin nr. 758, datë 30.01.2009, ka licencuar këtë shoqëri për subjektin audio privat vendor "Radio Ora". Subjekti është pajisur me licencë për shërbim programi audioviziv, me vendimet e AMA-s, nr. 131, datë 30.09.2019 dhe nr. 142, datë 04.10.2019, për të ofruar shërbim në qarqet Fier, Tiranë dhe Durrës.

Shoqëria "Ora" sh.a., me shkresën nr. 3002 protokolli ynë, datë 09.08.2019, ka depozituar kërkesën përmes së cilës ka parashtruar se: *"...Shoqëria "Ora" sh.a., paraqet këtë kërkesë pranë institucionit tuaj për të ndryshuar emrin e subjektit nga Tv Ora News në TV Ora. Në lidhje me këtë kërkesë janë marrë vendimet përkatëse të asamblesë së aksionarëve të*

shoqërisë si dhe do të bëhen edhe ndryshimet përkatëse në Regjistrin tregtar të QKB pasi kjo të jetë konfirmuar edhe nga institucioni juaj...”

AMA, me shkresën nr. 3002/1 prot., të datës 15 gusht 2019, kërkoi nga subjekti depozitimin e Certifikatës së Regjistrimit të logos apo markës, të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave, lidhur me përdorimin e emrit “Tv Ora”.

Në vijim, shoqëria “Ora” sh.a., me shkresën nr. 3002/2 prot., datë 02.09.2019, ka depozituar fotokopje të noterizuar me nr. 5856 rep., të datës 02.09.2019, të Certifikatës së Regjistrimit të markës për një periudhë 10 vjeçare, të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale, për regjistrimin e markës “Tv Ora”, me pronar shoqërinë “Ora” sh.a., me numër regjistrimi 19100.

Në mbështetje të parashikimeve të ligjit nr. 97/2013, i ndryshuar, subjektet kanë detyrimin ligjor të njoftojnë për ndryshimet e ndodhura në të dhënat e paraqitura në kërkesën për licencë/autorizim, brenda afatit prej 30 ditësh nga data e kryerjes së ndryshimeve. AMA konstaton se subjekti ka njoftuar mbi ndryshimet e ndodhura brenda afatit të përcaktuar ligjor.

Sa më sipër, AMA e gjen të drejtë e të mbështetur kërkesën e subjektit, shoqërisë “Ora” sh.a. për ndryshimin e emrit të shërbimit programor nga “Tv Ora News” në “Tv Ora”.

PËR KËTO ARSYE,

Autoriteti i Mediave Audiovizive, në mbështetje të nenit 19, pika 16 të ligjit nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

V E N D O S I:

1. Pranimin e kërkesës së subjektit, shoqëria “Ora” sh.a., duke ndryshuar emrin e shërbimit të programit audioviziv nga “Tv Ora News” në “Tv Ora”.
2. Ngarkohet administrata e AMA-s për kryerjen e veprimeve të mëtejshme në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar:

Gentian SALA

Zëvendëskryetar:

Sami NEZAJ

Anëtarë:

Agron GJEKMARKAJ

Gledis GJIPALI

Suela MUSTA